



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë 25.09.2025

PROPOZIM PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë _____.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, si dhe kërkesës së Z. Edmond Aleks Gjoka për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1551 Prot, datë 08.10.2024,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Edmond Aleks Gjoka, për kontributin e çmuar në sportin e Pingpongut si sportist dhe trajner i talentuar me rezultate të shkëlqyera në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë!

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI

Ervis Moçka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur Zoti Edmond Aleks Gjoka, lindur më 18.05.1962 në qytetin e Vlorës, banues në Vlorë ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1551 Prot, datë 08.10.2024.

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur, dashurinë për sportin e Pingpongut, karrierën e gjatë si dhe arritjet e larta si në arenën kombëtare po ashtu edhe ndërkombëtare.

Zoti Gjoka prej afro 50 vitesh, me një përkushtim të lartë, pasion dhe punë të palodhur ka ushtruar sportin e Pingpongut si sportist profesionist dhe më pas si trajner.

Me lojën e tij dhe më pas nën drejtimin e tij, sporti i Pingpongut ka arritur majat më të larta brenda vendit por edhe jashtë duke u përfaqësuar denjësisht në aktivitete në Ballkan, Europë dhe më gjerë. Mjeshtri i Pingpongut shqiptar ka arritur që të sjellë në qytetin e Vlorës për periudhën 1985-2024, gjithsej 108 trofe nga veprimtari të ndryshme sportive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Me përkushtimin e tij, aftësitë intelektuale, punës këmbëngulëse si dhe formimit pedagogjik ky mjeshtër ka përcjellë te brezi i ri dashurinë për sportin. Arritjet kanë qenë të larta gjatë periudhës 1988-2001, vite kur z. Gjoka stërviti ekipin kombëtar. Fituesi i çdo veprimtarie sportive, sportisti i cili ka patur gjithmonë një vend në podium, Anëtar i Federatës Shqiptare të Pingpongut, ka kontribuar më tej duke botuar disa shkrime sportive dhe dy libra historiko-statistikor për sportin.

Bashkëlidhur kërkesës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrimi;
- Çertifikatë familjare, me datë 07.10.2024;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
- Fotografi nga veprimtari të ndryshme, (4 fletë);
- Vërtetim negativ nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me datë 17.06.2025.
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mirënjohje" dhënë nga Shoqata "Federata Shqiptare e Pingpongut", muaji Maj 2015, me motivacion "Mjeshtër Sporti" për kontributin e dhënë në sportin e ping-pong në vite";
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mjeshtër i Madh" dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 13011, datë 09.04.2021 me motivacion "Në shenjë vlerësimi për kontributin shumëvjeçar në sportin e Pingpongut si sportist dhe trajner i talentuar me rezultate të larta në veprimatritë kombëtare dhe ndërkombëtare";
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, viti 2016, si fitues së vendit FAIR PLAY, në kampionatin Kombëtar U 12 vjeç;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mirënjohje" dhënë nga Federata Shqiptare e PingPongut, me motivacion "Për kontributin e dhënë në sportin e Pingpongut, fitues i shumë trofeve në vite";
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Finalet e Kampionatit Kombëtar për të rejtat në Ping-Pong, dhënë Ekipit "Flamurtari", Tetor 1988 (vend i dytë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Finalet e Kampionatit Kombëtar për të rejtat në Ping-Pong, dhënë Ekipit "Flamurtari", Tetor 1989 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në kupën e FSHL-së në pingpong ekipor femra nga Ekipi "Flamurtari", Tetor 1990 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për të rejtat, dhënë nga Komisioni Qëndror i Pingpongut, Nëntor 1990 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar të Pingpongut ekipor për femra, Maj 1991 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për të rejtat, dhënë nga Komisioni Qëndror i Pingpongut, Tetor 1991 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për vajza të rritura, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, Prill 1992 (vend i parë);

*Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)*

*Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për femra të reja, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, Prill 1992 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Diplomës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për çift femrash të reja , dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, Prill 1992 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor për të rritura, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, 2023 (vend i tretë);
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës marrë në Kampionatin Kombëtar ekipor U – 9 vjeçar femra, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, 2023 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës marrë në Kampionatin Kombëtar Kupa “Pavarësia”, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut, 2017 (vend i parë);
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës marrë në Kampionatin e vitit 2014, mosha 15-vjeçare, femra, dhënë nga Federata Shqiptare e Pingpongut (vend i tretë);

Duke u bazuar në kërkesën e Zotit Edmond Gjoka (bashkëlidhur së cilës gjenden rreth 42 Çertfikata, diploma dhe tituj) , në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, mendojmë se kërkuesi plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Jurist

Alma Myrtaj